54	Kristaq	Mano	2765	119/10	2377	149500	Proces regjistrimi
55	Pavlo	Konomi	2765	105/6	1728	71500	Proces regjistrimi
56	Pavli	Ceko	2765	57/5	667	123500	Proces regjistrimi
57	Andrea	Maka	2765	57/6	648	97500	Proces regjistrimi
58	Mihallaq	Toshi	2765	57/1	2630	104000	Proces regjistrimi
59	Llazi	Konomi	2765	55/2/1	1108	52000	Proces regjistrimi
60	Mihal	Shteto	2765	105/17	594	19500	Proces regjistrimi
61	Minella	Konomi	2765	119/4,119/7	1366	182000	Proces regjistrimi
62	Mihal	Canoi	2765	132/1/25;132/1/3	2030	195000	Proces regjistrimi
63	Avram	Paco	2765	132/1/63;132/1/1	1205	78000	Proces regjistrimi
64	Theodhoraq	Mano	2765	132/1/26	450	58500	Proces regjistrimi
65	Grigor	Mano	2765	132/1/34	926	26000	Proces regjistrimi
66	Dhimo	Qirko	2765	132/1/29	3200	279500	Proces regjistrimi
67	Pandeli	Ceko	2765	132/1/22,119/2	1321	123500	Proces regjistrimi
68	Goli	Pasko	2765	132/1/7,132/1/30	1900	123500	Proces regjistrimi
69	Maqo	Qirko	2765	132/1/1,132/1/72	1468	195000	Proces regjistrimi
70	Panajot	Papa	2765	132/5/7	498	78000	Proces regjistrimi
71	Pandeli	Shteto	2765	132/5/12	1268	104000	Proces regjistrimi
		Shuma				7091500	

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NË SEGMENTIN RRUGOR LEVAN -VLORË
PËR KULTURAT BUJQËSORE DHE DRU FRUTORË

QARKU: VLORË
KOMUNA: NOVOSELË
FSHATI: CERGOVINË, SKROFOTINË

Nr.	Emri	Mbiemri	Z.K.	Nr. i pasurisë	Nga kjo/ sip. e mbjellë	Bimë arash/ vlera lekë	Dru frutorë/ vlera lekë	Totali lekë	Shënime
1	Rushan	Gjinollari	1379	205/17	1512	18144		18144	Konfirmim nga ZRPP-ja
2	Zydi	Meta	1379	203/2	712	8544		8544	Konfirmim nga ZRPP-ja
3	Farudin	Metaj	1379	203/1	169	2028		2028	Konfirmim nga ZRPP-ja
4	Tahir	Shametaj	1379	203/11	3099	49584		49584	Konfirmim nga ZRPP-ja
5	Novruz	Shametaj	1379	203/9	1157	13884		13884	Konfirmim nga ZRPP-ja
6	Fuat	Shametaj	1379	203/12	681	10896		10896	Konfirmim nga ZRPP-ja
7	Bekim	Metaj	1379	203/3	1073		170607	170607	Konfirmim nga ZRPP-ja
8	Kristaq	Bregova	1379	67/28	1206		191754	191754	Konfirmim nga ZRPP-ja
9	Selman	Mecaj	1379	203/6	1043	12516		12516	Konfirmim nga ZRPP-ja
10	Lirim	Metaj	1379	203/4	614		97626	97626	Konfirmim nga ZRPP-ja
	Totali					115596	459987	575583	

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NË SEGMENTIN RRUGOR LEVAN -VLORË
PËR KULTURAT BUJQËSORE DHE DRU FRUTORË

QARKU :VLORË
KOMUNA:NOVOSELË
FSHATI :NOVOSELË

Nr.	Emri	Mbiemri	Z.K.	Nr. i pasurisë	Nga kjo/ sip. e mbjellë	Bimë arash/vlera lekë	Dru frutorë/ vlera lekë	Totali lekë	Shënime
1	Dhimitraq	Mocka	2813	45/13	1115	13380		13380	Konfirmim nga ZRPP-ja
2	Trifon	Mocka	2813	45/30,45/17	3013	36155		36155	Konfirmim nga ZRPP-ja
3	Pirro	Hyso	2813	44/15,54/30	1420	22720		22720	Konfirmim nga ZRPP-ja
4	Jani	Carri	2813	54/1	945	15120		15120	Konfirmim nga ZRPP-ja
5	Vasillaq	Hyso	2813	44/22	210	3360		3360	Konfirmim nga ZRPP-ja
6	Leonidha	Hyso	2813	54/9	740	11848		11848	Konfirmim nga ZRPP-ja
7	I pasaktësuar		2813	43/71	237	71683		71683	Nuk është saktësuar pronari nga ZRPP
8	I pasaktësuar		2813	43/72	594		112446	112446	Nuk është saktësuar pronari nga ZRPP-ja
9	Gori	Lepuri	2813	44/2	441		107719	107719	Konfirmim nga ZRPP-ja
10	Dhimitraq	Mocka	2813	54/4	1047		166473	166473	Konfirmim nga ZRPP-ja
11	Vllasi	Mocka	2813	54/6	737		117183	117183	Konfirmim nga ZRPP-ja
12	Josif	Carri	2813	43/73	747		118773	118773	Konfirmim nga ZRPP-ja
13	Odise	Hyso	2813	44/12	1122		286200	286200	Konfirmim nga ZRPP-ja
14	Kristaq	Hyso	2813	44/18	585		165000	165000	Konfirmim nga ZRPP-ja
15	Vllasi	Lepuri	2813	54/27	381		60579	60579	Konfirmim nga ZRPP-ja
16	Jani	Hyso	2813	54/11	386		82500	82500	Konfirmim nga ZRPP-ja
17	Dhimitraq	Hyso	2813	44/9	535		110000	110000	Konfirmim nga ZRPP-ja
18	Agron	Hyso	2813	44/8	544		165000	165000	Konfirmim nga ZRPP-ja
19	Vangjel	Lepuri	2813	44/3	489		38955	38955	Proces Regjistrimi
20	Thoma	Mocka	2813	54/17	441		70119	70119	Konfirmim nga ZRPP-ja
21	Katerina	Mocka	2813	54/16	323		51357	51357	E pasaktësuar
22	Llambi	Hyso	2813	54/10	545		86655	86655	Konfirmim nga ZRPP-ja
23	Toli	Lepuri	2813	54/46	3650		407500	407500	Konfirmim nga ZRPP-ja
24	Niko	Lala	2813	54/44	1259	20144		20144	Konfirmim nga ZRPP-ja
25	Vasil	Lala	2813	54/47	2055	32880		32880	Konfirmim nga ZRPP-ja
26	Mihal	Qarri	2813	54/3	772	12352		12352	Konfirmim nga ZRPP-ja
						239642	2146459	2386101	

VENDIM
Nr.25, datë 19.1.2011

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1282, DATË 23.12.2009, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KUOTËN E PRANIMIT DHE TARIFËN E SHKOLLIMIT NË
PROGRAMET E CIKLIT TË TRETË, TË STUDIMEVE SPECIALIZUESE AFATGJATA, NË
FAKULTETIN E MJEKËSISË TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS, PËR VITIN AKADEMIK
2009-2010”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, pika 1.3.2, 34, 35 dhe 75, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit nr.1282, datë 23.12.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Kuota e pranimit në programet e ciklit të tretë, të studimeve specializuese afatgjata, në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Tiranës, të jetë 446, e ndarë në specialitete, sipas shtojcës nr.1/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

2. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

3. Efektet financiare, për zbatimin e këtij vendimi, përballohen nga buxheti i Universitetit të Tiranës, pa efekte buxhetore shtesë.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SHTOJCA NR.1/1
KUOTA E PRANIMIT NË STUDIMET SPECIALIZUESE AFATGJATA NË FAKULTETIN E
MJEKËSISË TË UT-SË

Nr.	Programi i specializimit	Ministria e Shëndetësisë	Ministria e Mbrojtjes	Ministria e Drejtësisë	Ministria e Arsimit	Trojet shqiptare	Kuota të pambuluara	Shuma
1	Alergologji	7	-	-	-	-	3	10
2	Anatomi patologjike	5	-	-	-	-	5	10
3	Anestezi-reanimacion	19	-	-	-	-	1	20
4	Dermatologji	13	-	-	-	-	-	13
5	Endokrinologji	9	-	1	-	-	2	12
6	Gastrohepatologji	4	-	-	-	-	4	8
7	Hematologji	6	1	-	-	-	2	9
8	Diagnozë me imazhe	9	2	-	-	-	1	12
9	Kardiokirurgji	5	-	-	-	-	-	5
10	Kardiologji	11	-	2	-	1	4	18
11	Kirurgji e përgjithshme	15	2	-	-	-	3	20
12	Kirurgji maksilo-faciale	10	-	-	-	-	-	10
13	Laborator klinik-biokimik	7	1	-	-	-	5	13
14	Mikrobiologji	7	-	-	-	-	3	10
15	Mjek familjeje	19	-	-	-	-	16	35
16	Mjekësi interne	10	2	-	-	1	6	19
17	Mjekësi ligjore	-	-	-	-	-	5	5
18	Nefrologji	3	-	-	-	-	7	10
19	Neurologji	5	1	-	-	-	4	10
20	Neurokirurgji	5	2	-	-	-	2	9
21	ORL	4	-	1	-	-	2	7
22	Obstetrikë-gjinekologji	13	-	-	-	1 (Presh.)	5	19
23	Okulistikë	7	-	-	-	-	3	10
24	Onkologji	6	-	-	-	-	7	13
25	Ortopedi-traumatologji	1	-	-	-	-	8	9
26	Pediatri	21	-	-	-	-	3	24
27	Pneumologji	2	1	-	-	-	9	12
28	Psikiatri	3	1	2	-	-	2	8
29	Psikiatri e fëmijëve dhe adoleshentëve	2	-	-	-	-	6	8
30	Reumatologji	10	-	-	-	-	2	12
31	Sëmundje infektive	16	-	-	-	-	4	20
32	Shëndet publik	12	2	-	-	-	-	14
33	Terapi stomatologjike	11	-	-	-	-	4	15
34	Toksikologji klinike	-	-	-	-	-	5	5
35	Mjek urgjence	12	-	-	-	-	-	12
	Gjithsej	289	15	6	-	3	133	446

VENDIM
Nr.42, datë 12.1.2011

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES HIDROKARBURE SHITESË TË KONTRATËS ME
NDARJE PRODHIMI, NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE
ENERGJETIKËS (MË PARË E NJOHUR SI MINISTRIA E INDUSTRIËS DHE
ENERGJETIKËS) SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA AGJENCIA
KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE, DHE ISLAND INTERNATIONAL EXPLORATION
B.V. E BEACH ENERGY LIMITED, PËR BLOKUN “DURRËSI”
(NË DET), SHQIPËRI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 13 të ligjit nr.7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes hidrokarbure shitesë të kontratës me ndarje prodhimi, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (më parë e njohur si Ministria e Industrisë dhe Energjetikës) së Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, dhe Island International Exploration b.v. e Beach Energy Limited, për bllokun “Durrësi” (në det), Shqipëri, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.1, datë 13.1.2011

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.3551, DATË 23.7.2003 “MBI REGJISTRIMIN E
MJETEVE RRUGORE”**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 92 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” dhe pikës 5 të nenit 237 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.153, datë 7.4.2000 “Rregullorja e zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.3551, datë 23.7.2003 “Mbi regjistrimin e mjeteve rrugore”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Neni 3 pika 6 shkronja “b”, paragrafi i dytë, ndryshohet si vijon:
“Për subjektet juridike, ekstrakt i QKR-së, në origjinal.”.
2. Neni 3, pika 6, shkronja “c” ndryshohet si vijon:
“Kartën e identitetit, e cila pasi fotokopjohet dhe legalizohet nga nëpunësi i pranimit sipas rregullave në fuqi, i kthehet përsëri klientit”.
3. Neni 11, pika 1, shkronja “f” ndryshohet si vijon:
“Kur pronari ndryshon rrethin e vendbanimit, dorëzon targat vetëm nëse ato janë të sistemit të vjetër.”.
4. Neni 11, pika 3, shkronja “e” ndryshohet si vijon:

“Sipas procedurave të përcaktuara nga DPSHTRR-ja magazinon targat nëse ato janë sipas sistemit të vjetër.”.

5. Neni 11, pika 3, shkronja “h” ndryshohet si vijon:

“I dorëzon klientit targat e reja të mjetit, në rastet kur ky i fundit ka pasur targa të sistemit të vjetër.”.

6. Neni 11, pika 4, shkronja “e” ndryshohet si vijon:

“Sipas procedurave të përcaktuara nga DPSHTRR-ja magazinon targat nëse ato janë sipas sistemit të vjetër.”.

7. Neni 11, pika 4, shkronja “g” ndryshohet si vijon:

“I dorëzon klientit targat e reja të mjetit, në rastet kur ky i fundit ka pasur targa të sistemit të vjetër.”.

8. Neni 13, pika 1, shkronja “h” ndryshohet si vijon:

“Kur pronari ndryshon rrethin e vendbanimit, dorëzon targat, vetëm nëse ato janë të sistemit të vjetër.”.

9. Neni 13, pika 3, shkronja “e” ndryshohet si vijon:

“Sipas procedurave të përcaktuara nga DPSHTRR-ja magazinon targat nëse ato janë sipas sistemit të vjetër.”.

10. Neni 13, pika 3, shkronja “i” ndryshohet si vijon:

“I dorëzon klientit targat e reja të mjetit, në rastet kur ky i fundit ka pasur targa të sistemit të vjetër.”.

11. Neni 13, pika 4, shkronja “e” ndryshohet si vijon:

“Sipas procedurave të përcaktuara nga DPSHTRR-ja, magazinon targat nëse ato janë sipas sistemit të vjetër.”.

12. Neni 13, pika 4, shkronja “g” ndryshohet si vijon:

“I dorëzon klientit targat e reja të mjetit, në rastet kur ky i fundit ka pasur targa të sistemit të vjetër.”.

13. Neni 24, pika 1, shkronja “c” ndryshohet si vijon:

“Kur pronari ndryshon rrethin e vendbanimit, dorëzon shenjën e identifikimit të ciklomotorit, vetëm nëse ajo është sipas sistemit të vjetër.”.

14. Neni 24, pika 3, shkronja “d” ndryshohet si vijon:

“Sipas procedurave të përcaktuara nga DPSHTRR-ja, magazinon shenjën e identifikimit të ciklomotorit, vetëm nëse ajo është sipas sistemit të vjetër.”.

15. Neni 24, pika 3, shkronja “g” ndryshohet si vijon:

“I dorëzon klientit shenjën e re të identifikimit të ciklomotorit, në rastet kur ky i fundit ka pasur shenjë identifikimi të sistemit të vjetër.”.

16. Neni 24, pika 4, shkronja “d” ndryshohet si vijon:

“Sipas procedurave të përcaktuara nga DPSHTRR-ja, magazinon shenjën e identifikimit të ciklomotorit, vetëm nëse ajo është sipas sistemit të vjetër.”.

17. Neni 24, pika 4, shkronja “e” ndryshohet si vijon:

“I dorëzon klientit shenjën e re të identifikimit të ciklomotorit, në rastet kur ky i fundit ka pasur shenjë identifikimi të sistemit të vjetër.”.

18. Në nenin 46, pas pikës 2, shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

“3. Përsëritja e autorizimit të provës:

a) Zyra e regjistrimit bën shënimet përkatëse në regjistrin e targave të provës.

b) Sipas procedurave të përcaktuara nga DPSHTRR-ja, magazinon targën vetëm nëse ajo është sipas sistemit të vjetër.

c) I dorëzon subjektit targën e re të provës, vetëm në rastet kur subjekti ka pasur targë të sistemit të vjetër.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

UDHËZIM
Nr.5, datë 31.1.2011

**PËR DISA SHTESA NË UDHËZIMIN NR.17, DATË 13.5.2008 “PËR TATIMIN MBI
VLERËN E SHTUAR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.17, datë 13.5.2008 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 8.8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“8.8 Ambalazhet, materialet e barnave dhe furnizimi i barnave

8.8.1 Furnizimi i ambalazheve e materialeve të barnave

Furnizimi i ambalazheve e materialeve që përdoren për prodhimin dhe konfeksionimin e barnave, janë furnizime të përjashtuara.

8.8.2 Furnizimi i barnave

Furnizimi i barnave, shërbimeve shëndetësore nga institucionet shëndetësore, publike dhe private, është furnizim i tatueshëm me shkallën tatimore 10 për qind.

8.8.2.1 Për furnizimin e barnave aplikohet TVSH-ja 10 për qind.

Për barnat e importuara dhe të prodhuara në vend, të pajisura me pullën e kontrollit me çmimin pa TVSH, që rezultojnë gjendje në subjektet farmaceutike deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit nr.10 363, datë 16.12.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, nuk do të aplikohet TVSH-ja.

Të gjitha pullat e kontrollit të barnave që shiten nga data 1 shkurt 2011, do të kenë të përfshirë TVSH-në në çmimin përfundimtar të shitjes.

Qendra e Kontrollit të Barnave merr masa që në pullën e kontrollit të barnave të evidentohet çmimi përfundimtar me TVSH.

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2011, çdo person juridik apo fizik, importues apo prodhues i barnave, në fund të çdo muaji, do të deklarojë stokun në organin tatimor ku është i regjistruar.”.

2. Forma dhe përmbajtja e “Librit të blerjeve”, “Librit të shitjeve” dhe “Formulari i deklarimit dhe pagesës së TVSH-së” janë sipas formularit bashkëngjitur këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCVE
Ridvan Bode

FORMULAR I DEKLARIMIT DHE PAGESES SE TVSH



(2) Periudha tatimore

Numri i Vendosijes se Dokumentit (NVD)
(Vetem per perdorim zyrtar)

(1) Numri Serial: _____

Numri Identifikues i Personit te Tatueshem (NIPT): (3) _____
Emri Tregtar i Personit te Tatueshem: (4) _____
Emri Mbiemri i Personit Fizik: (5) _____
Adresa: (6) _____
Qyteti/Komuna/Rrethi: _____
Numri Telefonit: (7) _____

Informacioni i mësipërm(rubrikat 4, 5,6,7) duhet të jetë i saktë dhe i azhurnuar.

☐ [8] Shenoni 'X' nëq gjate muajit nuk eshte bere asnje transaksion.Vendosni Daten,Firmosni dhe dorezoni Deklaraten.

TVSH e llogaritur për muajin

- (9) Shitje të përjashtuara
- (10) Eksporte/Furnizime me shkalle 0%
- (11) Shitjet e tatueshme me shkalle 20%
- (13) Shitjet e tatueshme me shkalle 10%

Vlera e tatueshme

TVSH i llogaritur

(9)	
(10)	
(11)	(12)
(13)	(14)

TVSH e paguar për muajin

- (15) Blerje të përjashtuara,TVSH jo e zbritshme,pa tvsh
- (16) Importe me shkalle tatimore 20%
- (18) Importe me shkalle tatimore 10%
- (20) Blerje nga furnitore vendas me shkalle 20%
- (22) Blerje nga furnitore vendas me shkalle 10%
- (24) Blerje nga fermeret vendas

Vlera e tatueshme

TVSH i zbritshëm

(15)	
(16)	(17)
(18)	(19)
(20)	(21)
(22)	(23)
(24)	(25)

Saktësime

- (26) TVSH i zbritshëm,mbartur nga muaji kaluar
- (27) Kërkesë rimbursimi i tepriës së TVSH së zbritshme nga muaji kaluar
- (28) Gjendja TVSH së zbritshme nga muaji kaluar{(26)-(27)}
- (29) Totali TVSH së zbritshme te muaji {(17)+(19)+(21)+(23)+(25)+(28)}
- (30) Teprica TVSH të zbritshme{(29)-(12+14)}nq{(29)>(12+14)}
(Të mbartet në muajin pasardhës)
- (31) TVSH I DETYRUESHEM PER TU PAGUAR{(12+14)-(29)}
nqs{(12+14)>(29)}
- (32) Gjoha për vonesa në Pagesë/Dorëzim deklarate
- (33) TOTALIPER TU PAGUAR

(26)	
(27)	
	(28)
	(29)
(30)	
	(31)
	(32)
	(33)

Data dhe Firma e Personit te Tatueshem - Deklaroj nen pergjegjesine time qe informacioni i mesipem eshte i plote dhe i sakte.

Vetem per perdorim zyrtar

☐ Leke ☐ Cek
☐ Xhirim ☐ Te tjera

PAGESA

(34) SHUMA E PAGUAR:

Data , Vula e Bankes dhe nenshkrimi i nepunesit te banles

Originali - Drejtoria Rajonale Tatimore
Kopja - Personi i Tatueshem

Formulari i Deklarimit dhe Pagesws (FDP) sw TVSH-sw

1. Numri serial perdoret nga Drejtoria Rajonale Tatimore dhe sherben per te azhornuar regjistrimet tuaja kur paraqitet deklarata
2. Periudha Tatimore eshte muaji i paraqitur nga dita e pare deri ne ditën e fundit. Te gjitha transakcionet (Shitjet, Blerjet dhe saktësimet te TVSH-se se zbritshme (rubrika 28 e FDP-se) te kryera gjate kesaj periudhe duhet te perfishihen ne kete deklarate.

Te dhena te Personit te Tatueshem .

3. Numri Identifikues i Personit te Tatueshem (NIPT) eshte numri i vetemqë ju perfaqeson dhe identifikon ne te gjitha marredheniet me Administraten Tatimore Qendrore. Nipt-i duhet te vendoset detyrimisht ne çdo fature qe leshoni ose merrni.

4. Emri Tregtar i Personit te Tatueshem eshte emri me te cilin ju paraqini veprimtarine tuaj dhe qe tregohet ne certifikaten tuaj te NIPT-it.

5. Emri, Mbiemri i Personit Fizik vendoset kur veprimtaria ekonomike kryhet nga nje Person Fizik dhe nuk ka emer tregtar

6. Adresa tregohet per vendin kryesor te ushtrimit te veprimtarise tuaj ekonomike. Kjo adrese eshte e treguar edhe ne certifikaten tuaj te NIPT-it

7. Numri i Telefonit (nqs keni) tregon numrin e telefonit ne vendin kryesor te ushtrimit te veprimtarise tuaj ekonomike.

Shenim. Neqofese ndonje nga te dhena te rubrikave 4,5,6,7 ka ndryshuar, jeni te detyruar te deklaroni ne kohe, cdo ndryshim prane QKR-se dhe Drejtorise Rajonale Tatimore ku jeni i regjistruar.

8. Neqoftese ju nuk keni kryer asnje transakcion gjate muajit, shënoni një “X” ne kutinë 8. Sipas menyres se deklarimit, plotesoni datën dhe firmosni duke deklaruar ne kete menyre qe informacioni i dhene ne deklarate eshte i plote dhe i sakte.

Shitjet tuaja (Qarkullimi) për muajin

9. Nga kolona “**j**” e Librit te shitjeve “**Vlera e Tatueshme per shitje me shkalle 20%**” niximi totalin per transakcionet e bera gjate muajit dhe plotesoni shumën e përfutur ne kutinë 9 të Deklaratës tuaj. Per shitjet e përjashtuara nuk llogaritet TVSH.

10. Nga kolona “**Eksporte/Furnizime me shkalle 0%**” e librit tuaj të shitjeve niximi totalin e të gjithë eksporteve apo furnizimeve me shkalle tatimore 0% të bëra për muajin dhe plotesoni shumën e përfutur në kutinë 10 të Deklaratës tuaj. Furnizimet sipas nenit 31 te Ligjit “Per TVSH” (Eksportet, transporti nderkombetar, etj) taten ne 0%.

11. Nga kolona “**j**” e Librit te shitjeve “**Vlera e Tatueshme per shitje me shkalle 20%**” niximi totalin per transakcionet e bera gjate muajit dhe plotesoni shumën e përfutur në kutinë 11 të Deklaratës tuaj. Këto shitje te tatueshme i nënshtrohen shkalles per tvsh-ne prej 20%.

12. Nga kolona “**k**” “**TVSH per shitje me shkalle 20%**”, e Librit tuaj të Shitjeve, niximi totalin e tvsh-se per shitjet për muajin me shkalle 20% dhe shumën e përfutur vendoseni në kutinë 12 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 12 duhet të jete e barabarte me 20% të vlerës së paraqitur në kutinë 11.

13. Nga kolona “**l**” e Librit te shitjeve “**Vlera e Tatueshme per shitje me shkalle 10%**” niximi totalin per transakcionet e bera gjate muajit dhe plotesoni shumën e përfutur në kutinë 13 të Deklaratës tuaj. Këto shitje te tatueshme i nënshtrohen shkalles per tvsh-ne prej 10%.

14. Nga kolona “**m**” “**TVSH per shitje me shkalle 10%**”, e Librit tuaj të Shitjeve, niximi totalin e tvsh-se per shitjet për muajin me shkalle 10% dhe shumën e përfutur vendoseni në kutinë 14 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 14 duhet të jete e barabarte me 10% të vlerës së paraqitur në kutinë 13.

Blerjet tuaja gjatë Muajit.

15. Nga kolona “**h**” “**Blerje të përjashtuara, me TVSH jo të zbritshme dhe pa tvsh**” e Librit tuaj të Blerjeve, niximi totalin e këtyre blerjeve dhe plotesoni shumën e përfutur në kutinë 15 të Deklaratës tuaj. Për këto blerje nuk do të bëhet zbritje e TVSH. Ketu do te regjistrohen dhe blerjet pa tvsh.

16. Nga kolona “**p**” “**Vlera e Tatueshme e Importeve me shkalle 20%**” e Librit tuaj të Blerjeve, për muajin, niximi totalin e vleres se tatueshme te importit me shkalle 20% dhe plotesoni shumën e përfutur ne kutinë 16 të Deklaratës tuaj.

17. Nga kolona “**j**” - “**TVSH ne Import me shkalle 20%**” e Librit tuaj të Blerjeve, niximi totalin e TVSH-se ne import me shkalle 20% dhe plotesoni shumën e përfutur në kutinë 17 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 17 duhet të jetë e barabartë me 20% të vlerës së kutisë 16.

18. Nga kolona “**k**” - “**Vlera e Tatueshme e Importeve me shkalle 10%**” e Librit tuaj të Blerjeve, për muajin, niximi totalin e vleres se tatueshme te importit me shkalle 10% dhe plotesoni shumën e përfutur ne kutinë 18 të Deklaratës tuaj

19. Nga kolona “**l**” - “**TVSH ne Import me shkalle 10%**” e Librit tuaj të Blerjeve, niximi totalin e TVSH-se ne import me shkalle 10% dhe plotesoni shumën e përfutur në kutinë 19 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 19 duhet të jetë e barabartë me 10% të vlerës së kutisë 18.

20. Nga kolona “**m**” - “**Vlera e tatueshme nga furnitore vendas me shkalle 20%**” e Librit tuaj të Blerjeve, niximi totalin e këtyre blerjeve dhe plotesoni shumën e përfutur në kutinë 20 të Deklaratës tuaj.

21. Nga kolona “**n**” - “**TVSH per blerje nga furnitore vendas me shkalle 20%**” e Librit tuaj të Blerjeve, mbledhni totalin e këtyre blerjeve dhe plotesoni shumën e përfutur në kutinë 21 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 21 duhet të jetë e barabartë me 20% të vlerës së kutisë 20.

22. Nga kolona “**o**” - “**Vlera e tatueshme nga furnitore vendas me shkalle 10%**” e Librit tuaj të Blerjeve, niximi totalin e këtyre blerjeve dhe plotesoni shumën e përfutur në kutinë 22 të Deklaratës tuaj.

23. Nga kolona “**p**” - “**TVSH per blerje nga furnitore vendas me shkalle 10%**” e Librit tuaj të Blerjeve, mbledhni totalin e këtyre blerjeve dhe plotesoni shumën e përfutur në kutinë 23 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 23 duhet të jetë e barabartë me 10% të vlerës së kutisë 22.

24. Nga kolona “**q**” - “**Vlera e tatueshme e blerjeve nga fermerët vendas**” e Librit tuaj të Blerjeve, niximi totalin e këtyre blerjeve nga fermerët e paraqitur për TVSH dhe plotesoni shumën e përfutur në kutinë 24 të Deklaratës tuaj.

25. Nga kolona “**r**” - “**TVSH i zbritshëm, kompensimi i fermerëve**” e Librit tuaj të Blerjeve, mbledhni totalin e këtyre blerjeve dhe plotesoni shumën e përfutur në kutinë 25 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 25 duhet të jetë e barabartë me 6 % të vlerës së kutisë 24.

Saktësimet

26. Nqs në Deklaratën tuaj të muajit të kaluar keni një tepërcë TVSH të zbritshëm, paraqiteni atë në kutinë 26. Kjo shumë është treguar në kutinë 30 të Deklaratës tuaj të muajit të kaluar.

27. Nqs vlera e paraqitur në kutinë 26 është mbi 400000 lekë dhe për cdo deklaratë tuaj keni mbartur për 3 muaj të njëpasnjëshme TVSH të zbritshëm (vlera e treguar në kutinë 30, mbartur ne kutine 26 për 3 periudha te njëpasnjëshme) ju mund të paraqesni një kërkesë për Rimbursim të Tepërcës së TVSH të zbritshme dhe per kete pervec kerkesave te tjera duhet te plotesoni shumën e TVSH-se se kerkuar per rimbursim ne kutine 27 te deklarates. Përvec kesaj duhet te plotësoni Formularin e Kërkesës për Rimbursim me shumën që ju duhet të rimburoheni shoqëruar me kërkesë me shkrim. Per procedurat dhe dokumentat qe duhet te plotesoni per rimbursimin e tvsh-se duhet ti referoheni ne cdo kohe Ligjit dhe akteve nenligjore te nxjerra per kete qellim. Vlera qe do te plotesohet ne kutine 27 duhet te jete: mbartur per 3 periudha te njëpasnjëshme 400000 leke < (27) <= (26).

28. Llogarisni gjendjen e TVSH së zbritshme nga muaji i kaluar duke zbritur nga vlera e kutisë 26 vlerën e kutisë 27 dhe per rezultatin plotesoni kutinë 28.

Totali i TVSH të zbritshëm për Muajin.

29. Llogarisni totalin e TVSH së zbritshëm për muajin, duke mbledhur TVSH e zbritshëm për Importet me shkalle 20% (kutia 17); TVSH e zbritshëm për Importet me shkalle 10% (kutia 19); TVSH e zbritshëm për Blerjet nga furnizuesit vendas me shkalle 20% (kutia 21); TVSH e zbritshëm për Blerjet nga furnizuesit vendas me shkalle 10% (kutia 23); tvsh (kompensimi) i paguar për blerjet nga fermerët (kutia 25) dhe gjendjen e TVSH të zbritshëm nga muaji i kaluar (kutia 28). Shumën plotesojeni në kutinë 29.

Tepërcë e TVSH të zbritshëm.

30. Nqs totali i TVSH të zbritshëm për muajin (kutia 29) është më i madh se TVSH i llogaritur për shitjet e muajit me shkalle 20% dhe 10% ((kutia 12) + (kutia 14), keni një **Tepërcë TVSH të zbritshëm** dhe nuk duhet të bëni pagesë tvsh në këtë muaj. Llogaritni tepërcën e tvsh të zbritshëm duke zbritur nga vlera e kutisë 29 shumën e vlerës ne kutinë 12 dhe 14 dhe rezultatin e përfutur plotesojeni ne kutinë 30. Nqs shuma e vlerave te kutisë 12 dhe 14 është me e madhe ose e barabartë me vlerën e kutisë 29 shkruani zero në kutinë 30.

TVSH i detyrueshëm për tu paguar

31. Nqs shuma e TVSH-se se llogaritur për muajin me shkalle tatimore 20% dhe 10% ne kutine 12 dhe 14 te deklarates është më i madh se totali i TVSH të zbritshëm për muajin (kutia 29), keni rezultuar me **tvsh të detyrueshme për tu paguar**. Llogarisni TVSH e detyrueshëm për tu paguar duke zbritur vlerën e kutisë 29 nga shuma e kutive 12 dhe 14 dhe paraqiteni rezultatin e përfutur në kutinë 31. Nqs vlera e kutisë 29 është më e madhe ose e barabartë me shumën e kutisë 12 dhe 14, shkruani zero në kutinë 31.

Plotësoni Deklaratën dhe Paguani TVSH

Deklarata duhet të plotësohet dhe paraqitet nga ju në bankë për pagesë brenda datës 14 të muajit pasardhës nga muaji i treguar në Deklaratë si periudhë tatimore. Nqs ju keni pagesë për të bërë dhe e bëni këtë pagesë brenda kësaj date shënoni shumën e kutisë 31 në kutinë 34. Nqs bëhet një pagesë e pjeshme ose një pagesë e vonuar, detyrimin tuaj i shtohen gjoha dhe interese. Drejtoria Rajonale Tatimore mund t'ju tregojë vlerën që duhet të vendosni në kutinë 32. Mbledhni vlerën e kutisë 31 me atë të kutisë 32 dhe shënoni detyrimin total në kutinë 33. Vendosni datën e plotësimit të Deklaratës, firmoseni atë dhe paraqiteni në bankë, ku një kopje e kësaj deklarate do t'ju kthehet nga nempunsi i bankes pas pagesës. Për më shumë informacion lexoni aktet ligjore dhe nenligjore per TVSH-ne, (Ligjin dhe Udhëzimin e TVSH-se etj) ose merrni kontakt me Drejtorinë Rajonale Tatimore ku jeni i regjistruar.

Kjo deklarate eshte konceptuar ne baze te ligjit “Per TVSH-ne” dhe eshte e pershtatshme per te kryer deklarimin dhe pagesen e TVSH-se sipas menytrave te parashikuara ligjerisht.

Libri i Shitjeve

Shoqëria Emri i shoqërisë

Nipti Nipti i shoqërisë

Viti Viti për të cilin plotësohet libri (yyyy)

Muaji Muaji për të cilin plotësohet libri - muaji nga 01 deri 12

Pa veprimtari Ploteso **PO** nëse gjatë muajit nuk është bërë asnjë transaksion.

Fatura			Blerësi			Totali i shitjeve	Shitjet e përjashtuara	Eksporte/ furnizime me 0%	Shitje me shkallë 20%		Shitje me shkallë 10%	
Nr. i faturës	Numri serial	Data (dd/mm/yyyy)	Emri tregtar/ personi	Rrethi	NIPT				Vlera e tatueshme	TVSH	Vlera e tatueshme	TVSH
a	b	c	d	e	f	g= (h+i+j+k+l+m)	h	i	j	k	l	m
Shuma totale												
Kutia sipas formularit të deklarimit dhe pagesës së TVSH-së							kutia (9)	kutia (10)	kutia (11)	Kutia(12)	kutia (13)	kutia(14)

Emri Mbiemri

Shpjegim.

Në rastin kur ky libër do të printohet, për qëllime të ruajtjes/ mbajtjes së dokumentacionit, çdo faqe e printuar duhet të ketë në krye përmbajtjen / rreshtat nga 1 në 12.

Nr. i rreshtave mund të shtohet në përputhje me nr. e transaksioneve

Shoqëria	Emri i shoqërisë
Nipti	Nipti i shoqërisë
Viti	Viti për të cilin plotësohet libri (yyyy)
Muaji	Muaji për të cilin plotësohet libri - muaji nga 01 deri 12

Pa veprimtari ☐ Plotëso **PO** nëse gjatë muajit nuk është bërë asnjë transaksion.

Fatura			Shitësi			Totali i blerjeve (përfshirë TVSH)	Blerje										
Nr. i faturës	Numri serial	Data (dd/mm/yyyy)	Emri tregtar/ personi	Rrethi	NIPT /Kodi i fermerit		Të përjashtuara, me TVSH jo të zbritshme dhe pa TVSH	Importe me shkallë 20%		Importe me shkallë 10%		Nga furnitorë vendas me shkallë 20%		Nga furnitorë vendas me shkallë 10%		Nga fermerët vendas	
								Vlera e tatueshme	TVSH	Vlera e tatueshme	TVSH	Vlera e tatueshme	TVSH	Vlera e tatueshme	TVSH	Vlera e tatueshme	TVSH
a	b	c	d	e	f	g=(h+i+j+k+l+m+n+o+p+q+r)	h	i	j	k	l	m	n	o	p	q	r
Shuma totale																	
Kutia sipas formularit të deklarimit dhe pagesës së TVSH-së							kutia (15)	kutia (16)	kutia(17)	kutia (18)	kutia (19)	kutia (20)	kutia (21)	kutia (22)	kutia(23)	kutia (24)	kutia(25)

Emri Mbiemri

Në rastin kur ky libër do të printohet, për qëllime të ruajtjes/ mbajtjes së dokumentacionit, çdo faqe e printuar duhet të ketë në krye përmbajtjen / rreshtat nga 1 në 12.

URDHËR
Nr.4, datë 12.1.2011

PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E KRYERJES SË RIMBURSIMIT TË NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE TË PAGESËS PËR PAJISJET FISKALE DHE TAKSIMETRAT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 15 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, Ministri i Financave

URDHËRON:

1. Njësitë e qeverisjes vendore, që sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar dhe vendimit nr.1065, datë 29.12.2010 “Për kriteret dhe procedurat e kryerjes së rimbursimit nga taksa e biznesit të vogël, të pagesës për pajisjet fiskale dhe taksimetrat” të Këshillit të Ministrave, kanë bërë rimbursimin e subjekteve të biznesit të vogël, brenda datës 30 prill 2011, paraqesin pranë Ministrisë së Financave (sipas formatit bashkëlidhur këtij urdhri) kërkesën për vlerën që kërkohet për t’u rimbursuar deri në atë periudhë.

2. Kërkesa e njësive të qeverisjes vendore duhet të përmbajë:

a) Kërkesën me shkrim të firmosur nga nëpunësi i autorizuar i njësisë, me vlerën e fondit që kërkohet për t’u rimbursuar deri në atë periudhë.

b) Listën e subjekteve të biznesit të vogël që kanë përfituar rimbursim për pajisjen fiskale dhe taksimetrit (vlerën e saj, përfshirë edhe TVSH-në, por jo më shumë se vlera e përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1065, datë 29.12.2010) për ato subjekte që nuk janë të përfshirë në skemën e TVSH-së dhe që nuk regjistrohen në këtë skemë brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit nr.10 354, datë 18.11.2010, të rakorduar me degën rajonale të tatim-taksave.

3. Rakordimi i njësive të qeverisjes vendore me degët rajonale të tatim-taksave të bëhet në përputhje me kërkesat e pikës 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1065, datë 29.12.2010 “Për kriteret dhe procedurat e kryerjes së rimbursimit nga taksa e biznesit të vogël të pagesës për pajisjet fiskale dhe taksimetrat.”.

4. Kërkesat për rimbursim dërgohen në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit pranë Ministrisë së Financave, e cila i administron këto kërkesa deri në përfundimin e procedurës për rimbursimin e njësive vendore, që kanë bërë kërkesë. Dokumentet origjinale do të arkivohen në protokollin e Ministrisë së Financave.

5. Me marrjen në dorëzim të këtij dokumentacioni, Ministria e Financave propozon projektvendimin pranë Këshillit të Ministrave, për rimbursimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël për njësitë e qeverisjes vendore, sipas vlerave përkatëse, nga zëri kontigjencë, parashikuar në buxhetin e vitit 2011. Ky fond, te njësitë e qeverisjes vendore do të kompensojë pjesën e taksës së biznesit të vogël, e cila ka rimbursuar pajisjen fiskale apo taksimetrit.

6. Pas miratimit nga Këshilli i Ministrave të vendimit për kompensim të njësive të qeverisjes vendore, Ministria e Financave (Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit), bëjnë alokimin e fondeve për rimbursim sipas njësive të qeverisjes vendore, te degët përkatëse të thesarit.

7. Transferimi i fondeve do të kryhet te degët e thesarit: Ministria 10, kapitulli 01, programi 01120, artikulli 6870000 (Shpenzime të jashtëzakonshme), me kodet përkatëse të degës së thesarit. Shkresa do të shoqërohet me listën e njësive dhe fondeve përfituese.

8. Me marrjen e njoftimit, njësitë e qeverisjes vendore përpilojnë një faturë për arkëtim për vlerën e taksës së biznesit të vogël, të cilën duhet ta paraqesin në degën e thesarit.

Me marrjen e shkresës nga Ministria e Financave dhe faturës për arkëtim nga njësia e qeverisjes vendore, dega e thesarit do të bëjë xhirim të brendshëm, për çdo njësi, sipas vlerës në listën bashkëlidhur shkresës së Ministrisë së Financave, në artikullin/llogarinë 7002100 (taksa e biznesit të vogël), të çdo njësie të qeverisjes vendore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCVE
Ridvan Bode

Nr. rendor	Emërtimi i subjektit	Vlera e plotë e pajisjes fiskale	Vlera e rimbursuar	Vlera e plotë e taksimetrit	Vlera e rimbursuar	Shuma që kërkohet për t'u kompensuar (lekë)
1						
2						
3						
4						
5						
6						
7						
8						
9						
	Totali					

Drejtori/përgjegjësi i tatim-taksave

Kryetari i NJQV-së

Dega rajonale e tatim-taksave

Logoja e njësisë e qeverisjes vendore

Nr.....prot

Data.....2011

Për: Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit
Ministria e Financave, Tiranë

Lënda: Kërkesë për rimbursim të vlerës së taksës së biznesit të vogël

Në bazë të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011” dhe urdhrit nr...., datë2011, të Ministrit të Financave, bashkia/komuna kërkon rimbursimin e vlerës prejlekësh, të taksës së biznesit të vogël, me anë të së cilës ajo ka kompensuar bizneset për pajisjet fiskale dhe taksimetrat, deri në datën2011.

Bashkëlidhur, lista e detajuar e subjekteve dhe vlera e kërkuar, si dhe lista e rakorduar me degën rajonale të tatim-taksave.

Kryetari i NJQV

.....

VENDIM Nr.1, datë 10.1.2011

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve, 8 pika 2 germa “1”, dhe 9 pika 3 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 121 dhe 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, të nenit 15 të Rregullave dhe Procedurave të Shitjes së Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin nr.1, datë 9.1.2009, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 10.1.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e KESH sh.a. për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren e procedurave të shitjes së energjisë elektrike të furnizuesit vendas e të huaj, si dhe relacionin e drejtorive teknike të saj,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave dhe procedurave të shitjes së energjisë elektrike (bashkëlidhur këtij vendimi).

2. Shfuqizimin e vendimit nr.1, datë 9.1.2009 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë KESH sh.a. për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

RREGULLAT DHE PROCEDURAT E SHITJES SË ENERGIJESË ELEKTRIKE

Neni 1 **Autoriteti**

Këto rregulla hartohen në zbatim të nenit 8 pika 2 germa “1” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.338. datë 19.3.2008 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, të ndryshuar.

Neni 2 **Qëllimi**

Të sigurojë rregulla dhe procedura të thjeshta për operime të shpejta, bazuar në një proces konkurrues dhe transparent për realizimin e shitjes së energjisë elektrike pa cenuar sigurinë e furnizimit me energji elektrike të klientëve.

Neni 3 **Përcaktime**

Në këtë rregullore termat e përdorur më poshtë do të kenë kuptimin:

1. “ERE” do të thotë Enti Rregulator i Energjisë, i cili është institucioni rregulator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror.

2. “Autoriteti shitës” do të thotë Korporata Elektroenergjetike Shqiptare, e cila kryen aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike dhe të furnizuesit publik me shumicë.

3. “Titullari i autoritetit shitës” do të thotë Drejtori i Përgjithshëm i KESH sh.a.

4. “OSSH” do të thotë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, i cili kryen aktivitetin e shpërndarjes, si dhe aktivitetin e furnizuesit publik me pakicë (FPP).

5. “Shitje e energjisë elektrike” do të thotë kalimi në sasi dhe në kohë i energjisë elektrike nga autoriteti shitës te blerësit vendas dhe të huaj, kundrejt pagesës, dhe sipas procedurave në këtë rregullore, pa cenuar ose duke përmirësuar sigurimin me energji elektrike të nevojave të OST sh.a., OSSH sh.a./FPP dhe duke kontribuar në minimizimin e kostove të prodhimit.

6. “Plani i optimizimit të burimeve hidro” është programi i hartuar mbi baza vjetore, mujore, javore dhe ditore, nga KESH sh.a. që përcakton sasinë e energjisë elektrike që do të prodhohet në periudha të përcaktuara kohore, si dhe përcakton nivelin e prurjeve të pritshme dhe nivelin e rezervuarit të çdo centrali, me qëllim rritjen e sigurisë së furnizimit me energji dhe efikasitetit të shfrytëzimit të kaskadës nëpërmjet:

- prodhimit eficient të energjisë prej centraleve të kaskadës;
- kryerjes së transaksioneve fitimprurëse dhe minimizimin e kostove të prodhimit të energjisë;
- minimizimin e kalimit në situatat që imponojnë shkarkimin urgjent të ujit pa përfitim të energjisë elektrike nga kaskada.

7. “Prurje të mëdha” do të thotë prurje e ujit, në sasi të tillë që kërcënojnë arritjen e nivelit kritik në rezervuarin e hidrocentralit dhe imponojnë shkarkimin urgjent të ujit, pa përfitim të energjisë elektrike nga rezervuari, ndonëse hidrocentrali punon me kapacitetin maksimal disponibël.

8. “Shitje e energjisë elektrike në kushtet e prurjeve të mëdha” do të thotë shitje e energjisë elektrike nga autoriteti shitës, në kushtet e prurjeve të mëdha, kur hidrocentrali nuk punon me ngarkesë të plotë, për të bërë të mundur ngarkimin e tij me ngarkesën maksimale të lejuar, në mënyrë që të përjashtohet shkarkimi i ujit pa prodhim energjie elektrike.

9. “Kandidat” do të thotë një person fizik ose juridik që merr pjesë, ose që shpreh interes për të kontraktuar me Autoritetin Shitës për blerje të energjisë elektrike.

10. “Ftesa për shitje” përfaqëson dokumentin me anë të të cilit Autoriteti Shitës iu drejtohet kandidatëve të ndryshëm e që publikohet detyrimisht në faqen elektronike të Autoritetit Shitës.

11. “Urdhrat për kryerjen e procedurave të Shitjes” janë aktet ekzekutive të titullarit të Autoritetit Shitës që përcaktojnë të dhëna të karakterit tekniko-ekonomik si dhe përcaktojnë komisionet që do të ndjekin zbatimin e urdhrave.

12. “Oferta për blerje” është tërësia e dokumenteve, të dërguara me postë, *fax*, *e-mail* ose dorazi, me anë të së cilës një kandidat i përgjigjet ftesës për shitje të autoritetit shitës.

13. “Terma komercialë” është tërësia e elementeve që kanë të bëjnë me çmimet e energjisë elektrike dhe tarifatat apo pagesat e tjera që shoqërojnë transaksionin e shitjes.

Neni 4 **Përgjegjësitë**

Autoriteti shitës është përgjegjës për përcaktimin në sasi dhe në kapacitet të energjisë elektrike që do të shitet sipas procedurave të kësaj rregulloreje, si dhe për përcaktimin e periudhës kohore dhe programit të livrimit të saj e që bazohet mbi planin e optimizmit të burimeve hidro të kryer nga KESH sh.a. në përputhje me përcaktimet e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, dhe Kodit të Funksionit të Rrjetit në çdo rast pas plotësimit të nevojave të FPSH, OST dhe OSSH/FPP.

Neni 5 **Zbatimi**

Kjo rregullore do të zbatohet në rastet si më poshtë:

a) Për shitjet e kryera, për sasinë e energjisë elektrike, pa cenuar plotësimin e nevojave të OST sh.a. dhe klientëve tariforë në përputhje me pikën 6 të nenit 3 për periudhën gjatë së cilës do të kryhen shitjet në fjalë.

b) Shitjes së energjisë elektrike nga prurjet e mëdha, e kryer me synimin për të evituar shkarkimin e ujit pa prodhim energjie elektrike.

c) Për shitjet e kryera të energjisë elektrike për efekt të përfitimit ekonomik, ku çmimi njësi i shitjes së energjisë elektrike do të jetë gjithmonë më i lartë se ai i blerjes së energjisë elektrike brenda ditës/javës/muajit.

Neni 6 **Parimet për procedurat e shitjes së energjisë elektrike**

1. Shitja e energjisë elektrike do të zhvillohet në bazë të parimeve të transparencës dhe të efikasitetit ekonomike, të cilat çojnë në përfitim ekonomik për autoritetin shitës.

2. Autoriteti shitës do të dokumentojë të gjithë argumentet prezente që kanë përcaktuar se cilit prej rasteve të cituara në nenin 5 i korrespondon vendimi i marrë.

3. Sasia e energjisë elektrike që shitet, asnjëherë nuk duhet të dëmtojë interesat e klientëve tariforë. Nuk lejohet të bëhet shitje e energjisë elektrike për qëllim përfitimi, në rast se autoriteti shitës nuk përmbush, ose rrezikon të mos përmbushet, detyrimet kontraktuale ndaj OST sh.a. dhe OSSH sh.a./FPP.

Neni 7

Marrëveshjet/kontratat për shitjen e energjisë elektrike

1. Shitja e energjisë elektrike ndërmjet autoritetit shitës dhe shoqërive që ofrojnë blerje të energjisë elektrike, në kuptim të nenit 5 të këtyre rregullave, kryhet, sipas rastit, mbi bazë të:

a) marrëveshjeve që autoriteti shitës lidh me shoqëritë publike homologe të rajonit; Në këtë rast, autoriteti shitës lidh marrëveshje pas negociatave direkte që zhvillon me këto shoqëri.

b) kontratave midis palëve, që rrjedhin nga negociatat përkatëse që autoriteti shitës lidh me shoqëritë vendase ose të huaja që ofrojnë blerje të energjisë elektrike, sipas procedurave të përcaktuara në këtë rregullore.

2. Në rastet e procedurave të shitjes së energjisë elektrike, autoriteti shitës mund të vendosë aplikimin e një nga dy llojet e marrëveshjeve/kontratave të përcaktuara në paragrafët 1/a dhe a/b të këtij neni duke zbatuar gjithnjë procedurat sipas kësaj rregulloreje.

Neni 8

Kriteret e vlerësimit të ofertave

1. Në rastet e aplikimit të procedurave të shitjes së energjisë elektrike sipas germës “a” të nenit 5, sipas kësaj rregulloreje, autoriteti shitës, në ftesën për shitje që i drejton kandidatëve, përcakton kriterin e vlerësimit të ofertave, i cili në këtë rast do të jetë çmimi/njësi dhe/ose çmimet/njësi më të larta, të cilat rezultojnë të tilla në përfundim të procedurës së negocimit, deri në plotësimin e sasisë totale të përcaktuar për t'u shitur.

2. Për çdo shitje të energjisë elektrike që kryhet për efekt të prurjeve të mëdha në të gjitha rastet e përdorimit të procedurave si nëpërmjet bursës, marrëveshjeve me shoqëritë publike, apo kontratave që rrjedhin nga negociatat përkatëse sikurse përcaktohen në nenin 7, autoriteti shitës, në ftesën për shitje që i drejton kandidatëve, përcakton si kriter të vetëm vlerësimi shpalljen fituese të ofertës/ofertave të paraqitura me çmimin/njësi dhe/ose çmimet/njësi më të larta, të cilat rezultojnë të tilla në përfundim të procedurës së negocimit, deri në plotësimin e sasisë totale të përcaktuar për t'u shitur.

3. Për shitjet e energjisë elektrike të kryera sipas germës “c” të nenit 5, autoriteti shitës në ftesën për shitje që i drejton kandidatëve përcakton si kriter të vetëm vlerësimi shpalljen fituese të ofertës/ofertave të paraqitura me çmimin njësi më të lartë të shitjes sesa çmimi njësi më i lartë i blerjes së energjisë elektrike nga autoriteti shitës për të njëjtën periudhë që shitet.

4. Në të gjitha rastet e aplikimit të procedurave të shitjes sipas germës “a” të nenit 5 dhe për efekt të prurjeve të mëdha, autoriteti shitës nuk përlllogarit çmim/njësi minimal fillestar të shitjes.

Neni 9

Ftesa për shitje të energjisë elektrike

1. Për çdo shitje, në përputhje me nenin 5 të këtyre rregullave, titullari i autoritetit shitës harton ftesën me termat përkatës për shitjen e energjisë elektrike. Ftesa përmban, të paktën:

- sasinë e energjisë elektrike MWh që ofrohet për t'u shitur;
- grafikun ditor të livrimit;
- kohëzgjatjen e livrimit në ditë/javë/muaj;
- periudhën e plotë kohore të livrimit të energjisë elektrike të përcaktuar në marrëdhëniet kontraktuale (shitjes).

2. Për blerjet ekonomike, ftesa do të përmbajë, të paktën:

- sasinë e energjisë elektrike MWh që ofrohet për t'u shitur;
- grafikun ditor të livrimit në kohë/orar.

Neni 10

Procedura e shitjes së energjisë elektrike nëpërmjet kontratave të lidhura pas negociatave korrente të autoritetit shitës me palët ofertuese

1. Në bazë të kërkesës për shitje të energjisë elektrike, që hartohet nga strukturat e autoritetit shitës që janë përgjegjëse për menaxhimin e prodhimit të energjisë elektrike, titullari i

autoritetit shitës nxjerr urdhrin për krijimin e komisionit të shitjes për kryerjen e procedurave të shitjes së energjisë elektrike.

2. Urdhri për krijimin e komisionit të shitjes do të përmbajë, të paktën:

- sasinë e energjisë elektrike MWh, që ofrohet për shitje;
- grafikun ditor të livrimit;
- kohëzgjatjen e livrimit në ditë/javë/muaj;
- kriterin e vlerësimit të ofertave, në përputhje me përcaktimet e nenit 9.

Në çdo rast, titullari i autoritetit shitës mund të përcaktojë në këtë urdhër edhe kërkesa dhe kushte të tjera. Komisioni i shitjes përgatit ftesën për shitje që i drejtohet në mënyrë të dokumentuar të gjitha shoqërive vendase ose të huaja, që operojnë në tregun rajonal të energjisë elektrike. Ftesa përmban të paktën kërkesat e përcaktuara në nenin 10, si dhe termat komerciale të shitjes dhe afatin e dorëzimit të ofertave. Kjo kërkesë publikohet në faqen elektronike të autoritetit shitës në po të njëjtën ditë që iu drejtohet shoqërive të ndryshme nga autoriteti shitës.

3. Brenda afatit të përcaktuar në ftesën për shitje, komisioni i shitjes do të pranojë ofertat e kandidatëve të ndryshëm dhe do të lejojë pjesëmarrjen e përfaqësuesve të tyre gjatë hapjes së ofertave. Komisioni do të vlerësojë, jo më vonë se 24 orë nga pranimi i tyre, ofertat e paraqitura, do t'i krahasojë ato me kërkesat e përcaktuara në ftesën që i është drejtuar të gjitha shoqërive, si dhe do të klasifikojë paraprakisht ofertat që rezultojnë të vlefshme. Komisioni do të zbatojë të njëjtën procedurë edhe në kushtet e paraqitjes së vetëm një oferte.

4. Komisioni i shitjes negocion me shoqërinë apo shoqëritë e përzgjedhura nga ky komision pas shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave. Komisioni i shitjes do të negociojë, brenda 24 orësh, me shoqëritë, duke pasur si synim rritjen e çmimit/njësi të paraqitur nga shoqëritë, sigurimin e kapaciteteve të mjaftueshme të transmetimit, si dhe parametrat e tjerë tekniko-ekonomikë të ofertave. Komisioni i shitjes, në rast se shoqëritë që kanë paraqitur oferta me çmimin/njësi më të lartë, nuk kanë ofruar të blejnë gjithë sasinë e ofruar nga autoriteti shitës për shitje, mund t'u kërkojë këtyre të fundit të ofrojnë të gjithë sasinë e ofruar nga autoriteti shitës për shitje. Në përfundim të procedurës së negocimit, komisioni i shitjes do t'i paraqesë menjëherë për miratim titullarit të autoritetit shitës një raport përmbledhës të kryerjes së procedurave dhe propozimin për shpalljen fituese të shoqërisë/shoqërive që kanë paraqitur çmimet/njësi më të larta, deri në plotësimin e sasisë së ofruar nga KESH sh.a. për shitje.

5. Titullari i autoritetit shitës, jo më vonë se 24 orë nga marrja e raportit përmbledhës, pas miratimit të tij, shpall ofertën/ofertat fituese.

6. Komisioni i shitjes ka përgjegjësinë për ruajtjen e konfidencialitetit të të gjitha ofertave të marra nga të interesuarit.

7. Brenda një periudhe jo më shumë se 24 orë nga marrja e vendimit për shpalljen e ofertës/ofertave fituese, autoriteti shitës, nëpërmjet komisionit të shitjes, do të negociojë për lidhjen e kontratës. Nëse ofertuesi fitues refuzon të lidhë kontratën për blerjen e energjisë elektrike, atëherë autoriteti shitës do të procedojë me negocimin për lidhjen e një kontrate me ofertuesin e radhës.

8. I gjithë dokumentacioni, së bashku me kontratën e lidhur midis autoritetit shitës dhe ofertuesit fitues, do të regjistrohet dhe ruhet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 11

Deklarata e konfliktit të interesave

Para pranimit të ofertave, çdo anëtar i komisionit do të nënshkruajë deklaratën me anë të së cilës shpreh mungesën e konfliktit të interesave të tij me ofertuesit në përputhje me legjislacionin në fuqi. Nëse një nga anëtarët e komisionit është në kushtet e konfliktit të interesave me një nga ofertuesit, atëherë kryetari i komisionit do t'i kërkojë titullarit të autoritetit shitës zëvendësimin e tij. Deri në emërimin e anëtarit tjetër, komisioni nuk do të procedojë me vlerësimin e ofertave.

Neni 12

Procedura e ankimit administrativ

1. Çdo ofertues mund të kërkojë rishikim administrativ të procedurës së shitjes kur gjykon se një vendim i autoritetit shitës është marrë në kundërshtim me këtë rregullorë.

2. Në rastin e procedurës sipas germave “a” dhe “c” të nenit 5 të kësaj rregulloreje, ofertuesi i paraqet me shkrim (me postë, *fax*, *e-mail* ose dorazi) titullarit të autoritetit shitës brenda 48 orësh nga momenti i njoftimit të skualifikimit ose shkeljes së pretenduar ankesën përkatëse. Në këtë ankesë, ankimuesi duhet të tregojë emrin dhe adresën, referimin për procedurën konkrete ku ka marrë pjesë, bazën ligjore dhe përshkrimin e shkeljes së pretenduar. Me marrjen e ankesës si më sipër, titullari i autoritetit shitës pezullon vazhdimin e procedurës së shitjes në fjalë, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht dhe ky shqyrtim të jetë shprehur në formën e një vendimi të shkruar nga titullari i autoritetit Shitës, i cili i dërgohet ankimuesit (me postë, *fax*, *e-mail* ose dorazi) brenda 48 orësh nga marrja e ankesës.

3. Në rastin e shitjes për efekt të prurjeve të mëdha siç përcaktohet në shkronjën “b” të nenit 5 të kësaj rregulloreje, ofertuesi i paraqet me shkrim (me postë, *fax*, *e-mail* ose dorazi) titullarit të autoritetit shitës brenda 24 orësh nga momenti i njoftimit të skualifikimit ose shkeljes së pretenduar, ankesën përkatëse. Në këtë ankesë, ankimuesi duhet të tregojë emrin dhe adresën, referimin për procedurën konkrete ku ka marrë pjesë, bazën ligjore dhe përshkrimin e shkeljes së pretenduar. Me marrjen e ankesës si më sipër, titullari i autoritetit shitës pezullon vazhdimin e procedurës së shitjes në fjalë, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht dhe ky shqyrtim të jetë shprehur në formën e një vendimi të shkruar nga titullari i autoritetit shitës, i cili i dërgohet ankimuesit (me postë, *fax*, *e-mail* ose dorazi) brenda 24 orëve nga marrja e ankesës.

Në çdo rast të paraqitjes së një ankesë, autoriteti shitës është i detyruar të shprehet me vendim për pranimin apo refuzimin e ankesës.

Kur subjekti nuk është i kënaqur me trajtimin e ankesës nga titullari i autoritetit shitës, atëherë i drejtohet gjykatës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes sipas Kodit të Procedurës Civile.

4. Mosparaqitja e ankesës në përputhje të plotë me kushtet, termat dhe afatet e përcaktuara në këtë nen, e bën atë absolutisht të pavlefshme.

Neni 13

Monitorimi i shitjes së energjisë elektrike

1. Të gjitha operacionet e shitjes së energjisë elektrike do të dokumentohen me saktësi. Asnjë shitje nuk lejohet të kryhet pa dokumentacionin shoqërues të kërkuar.

2. Deri më datë 15 të çdo muaji titullari i autoritetit shitës paraqet në ERE një raport analitik argumentues mbi shitjet e kryera në muajin paraardhës në zbatim të nenit 5 të kësaj rregulloreje.

3. Autoriteti shitës ka detyrimin t’i japë në mënyrë transparente ERE-s të gjithë dokumentacionin e kërkuar prej saj, për shitjet e energjisë elektrike në kuadër të autoritetit të ERE për të monitoruar të licencuarit.

Neni 14

Rishikimi

Këto rregulla janë objekt rishikimi me vendim të Bordit të Komisionerëve sipas procedurave të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s.

Neni 15

Sanksione

Për shkeljen e këtyre rregullave, kur nuk përbën vepër penale, ERE vepron në përputhje me nenin 64 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

Neni 16

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

VENDIM
Nr.2, datë 10.1.2011

PËR MIRATIMIN E UDHËZUESIT PËR APLIKIMIN DHE TARIFAT E LIDHJES SË RE APO MODIFIKIMIT TË LIDHJES EKZISTUESE NË RRJETIN ELEKTRIK TË OST SHA

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, neni 18 pika 1 germa “c” të miratuar me vendimin nr.21, datë 18.3.2009, dhe pikës V.3.3 të Kodit të Rrjetit të Transmetimit, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.123, datë 24.10.2008, pikës 3.8.2 të licencës për aktivitetin e transmetimit, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.35, datë 9.7.2004, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.1.2011, kërkesën e OST sh.a. për miratimin e “Tarifave të lidhjeve të reja” në rrjetin e transmetimit nëpërmjet një drafti të udhëzuesit “Për aplikimin dhe tarifat e lidhjes së re apo modifikimit të lidhjes ekzistuese në rrjetin elektrik të OST”,

VENDOSI:

1. Të miratojë udhëzuesin për aplikimin dhe tarifat e lidhjes së re apo modifikimit të lidhjes ekzistuese në rrjetin elektrik të OST sh.a., (bashkëlidhur këtij vendimi).
 2. Ngarkohet OST sh.a. për zbatimin e vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
 3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë OST sh.a. për këtë vendim.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

UDHËZUES
PËR APLIKIMIN DHE TARIFAT E LIDHJES SË RE APO MODIFIKIMIT TË LIDHJES
EKZISTUESE NË RRJETIN ELEKTRIK TË OST-së
Tiranë, dhjetor 2010

1. Hyrje
 - 1.1 Qëllimi
Ky udhëzues përcakton mënyrën, formatin e aplikimit dhe tarifat përkatëse, sipas të cilave paguhen lidhjet e reja, modifikimet ose rritja e kapacitetit të lidhjeve ekzistuese, në rrjetin elektrik të OST. Këto pagesa kryhen për qëllimin e shpenzimeve që ndërlidhen me këto procese.
 - 1.2 Kërkesat ligjore
Ky udhëzues merr në konsideratë dhe zbaton kërkesat e ligjit për sektorin e energjisë elektrike, nr.9072, datë 22.5.2003, me shtesat dhe ndryshimet përkatëse, Kodit të Rrjetit të Transmetimit, Metodologjinë e përcaktimit të tarifës së shërbimit të transmetimit të përcaktuar nga ERE, si dhe aktet e tjera nënligjore që lidhen me funksionet kryesore të OST-së, në përputhje me licencën e marrë nga ERE.
2. Përkufizimet
Çdo përkufizim, i cili nuk gjendet në këtë dokument, mund të gjendet në ligjet përkatëse të sektorit të energjisë elektrike, në Kodin e Rrjetit-Kodi i Lidhjes, Rregullat e Tregut, Metodologjinë e Tarifave të ERE, e të tjera.
 - 2.1 Termat e përkufizuar:
“Tarifa për aplikim (pagesa)” është pagesa në kohën kur aplikohet për lidhje, e cila mbulon studimin e pranueshmërisë së lidhjes në rrjetin e transmetimit dhe përgatitjen e dokumentacionit për hartimin e marrëveshjes së lidhjes.

“Përdoruesi” është pala e interesuar dhe që ka aplikuar ose është në proces për lidhje të re, modifikim apo rritje të kapacitetit të lidhjes në rrjetin e OST-së.

“Aplikim për lidhje” është kërkesa për lidhje nga përdoruesi për lidhje të re, modifikim të lidhjes ekzistuese, përfshirë dhe rritjen e kapacitetit të lidhjes së vjetër në rrjetin e OST.

“Formati i aplikimit për lidhje” janë formate tip për lloj centrali gjenerues apo ngarkesë, përfshirë konsumator i kualifikuar, sikurse janë paraqitur në shtojcën 1.

“Kapaciteti i lidhjes” nënkupton fuqinë e plotë elektrike në MVA të ofruar për lidhje të re ose për rritje kapaciteti të lidhjes ekzistuese.

“Data e lidhjes” është data në të cilën asetet për lidhje janë apo konsiderohen të jenë plotësisht të lidhura në rrjetin e OST-së dhe që vetë OST-ja është në gjendje të sigurojë kapacitetin për lidhje.

“Oferta për lidhje” është një ofertë për lidhje në rrjetin e OST-së e dhënë brenda 60 ditëve ose 90 ditëve nga data e aplikimit për lidhje.

“Pala përgjegjëse për lidhje” është pala që mund të jetë përdoruesi ose/dhe OST-ja që merr përgjegjësinë për procesin e projektimit, tenderimit, ndërtimit, testimit dhe lëshimit në punë të një lidhjeje.

“Asetet direkte të lidhjes ose asetet indirekte” janë asetet që janë të ndërlidhura drejtpërdrejt me ndonjë ofertë të caktuar për lidhje.

“Afati i fundit për ofertë” është numri i ditëve pas dorëzimit të aplikimit për lidhje, brenda të cilave OST-ja duhet të bëjë ofertën për lidhjen.

“Tarifa për mbikëqyrje” është tarifa për kontrollin dhe vlerësimin e projektit teknik, mbikëqyrjen e ndërtimit, testimit dhe komisionimit të lidhjes.

“Përdoruesi i sistemit ose përdoruesi” është ai i lidhuri në sistemin e transmetimit duke qenë konsumator i lidhur direkt, furnizues në emër të konsumatorit të lidhur direkt, shpërndarës ose gjenerues.

“Lidhja e re” është central gjenerimi, linjë transmetimi, nënstacion, i lidhur në rrjetin e transmetimit në pikën/nyjën lidhëse, e përcaktuar me MVA, në nivelin nominal të tensionit.

“Pika e lidhjes” është pika e lidhjes fizike të një përdoruesi me rrjetin e transmetimit.

3. Përgjegjësit e lidhjes dhe tarifat

Tarifat për lidhje aplikohen vetëm ndaj lidhjeve të reja, modifikimit ose rritjes së kapacitetit të lidhjeve ekzistuese.

“Përdoruesi i sistemit” merr përgjegjësinë (është pala përgjegjëse për lidhje) për ndërtimin e aseteve të lidhjes (p.sh. të tenderojë dhe paguajë për blerjen, ndërtimin, testimin dhe vënien në punë) dhe:

- OST-ja do të mbikëqyrë procesin;
- pas lëshimit të suksesshëm në punë, OST-ja do të marrë pronësinë e aseteve të transmetimit deri në kufirin ndarës me asetet e përdoruesit, sipas përcaktimeve të Kodit të Rrjetit të Transmetimit.
- OST-ja do të ngarkojë tarifën për lidhje për përdoruesin, sipas përcaktimit të bërë në paragrafin 4.6.

4. Çështjet e zbatimit

4.1 Trajtimi i barabartë

Në pajtim me rregullat e tregut dhe licencën e OST-së, të gjithë përdoruesit do të trajtohen në baza jodiskriminuese, përveç nëse ka arsye të mirëfillta teknike për dallime.

4.2 Konfidencialiteti

I gjithë komunikimi ndërmjet një përdoruesi dhe OST-së është tërësisht konfidencial. OST-ja nuk do të diskutojë çështjet me palët e treta përveç nëse merr leje me shkrim nga përdoruesi.

4.3 Diskutimet paraprake

Përdoruesit ftohen të kenë diskutime fillestare me OST-në për lidhjet e mundshme. Si pjesë e këtyre diskutimeve, OST-ja mund të ofrojë një vlerësim paraprak dhe të përkohshëm për lidhjen. Këto diskutime preliminare nuk do të formojnë në vete një aplikim të lidhjes, por do të jenë nën një konfidencialitet të plotë.

4.4 Publikimi i kostos

OST-ja në faqen e saj në *web* do të publikojë vlerën aktuale të tarifës së aplikimit dhe tarifës për mbikëqyrje.

4.5 Aplikimi për lidhje

Të gjitha aplikimet për lidhje do të trajtohen në bazë të parimit “i pari vjen, i pari shërbehet”.

Një përdorues mundet t'i dorëzojë OST-së një aplikim për lidhje për lidhjen e ngarkesës ose gjenerimit në rrjetin e OST-së, të modifikojë ose të rrisë fuqinë e lidhjes ekzistuese. Kjo bëhet duke plotësuar dhe dorëzuar një format të aplikimit për lidhje së bashku me pagesën e tarifës për aplikim, i cili mbulon studimin fillestar të projektit, administrimin dhe përgatitjen e marrëveshjes për lidhje. Aplikimi për lidhje do të theksojë palën përgjegjëse për lidhje, i cili do të jetë përgjegjës për procesin e projektimit, tenderimit, ndërtimit, testimit dhe vënies në punë të lidhjes.

Aplikimi formal nga një përdorues do të nënkuptojë fillimin e planit kohor të lidhjes, që kërkon nga OST-ja të përgjigjet me një ofertë për lidhje brenda afatit të fundit për ofertë, që do të jetë:

- 60 ditë, kur janë mbajtur diskutime të suksesshme preliminare dhe studimet e projektit fillestar janë kryer plotësisht.

- 90 ditë, kur nuk është kryer ndonjë studim i përshtatshëm i sistemit dhe kërkohen të dhëna shtesë nga aplikuesi.

OST-ja realisht duhet të përgjigjet sa më shpejt që është e mundur.

Kur përdoruesi dëshiron të zbatojë lidhjen në disa faza kohore, atëherë përdoruesi:

- mund të vendosë të zbatojë vetëm fazën e parë me një aplikim për lidhje vetëm për atë fazë;
- mund të aplikojë formalisht për fazën e parë dhe të japë informacion për të gjitha fazat, përfshirë edhe afatet kohore;

- mund të aplikojë për të gjitha fazat me afatin kohor të përcaktuar për realizimin e secilës fazë.

Nëse oferta për lidhje pranohet duhet të nënshkruhet marrëveshja për lidhje.

4.6 Tarifa e lidhjes

Tarifa e lidhjes do të formohet prej dy njësive të veçanta.

1. Tarifa për aplikim (studimi i pranueshmërisë së lidhjes në rrjetin e transmetimit, përgatitja e dokumentacionit për marrëveshjen e lidhjes me përdoruesin). Kjo tarifë është fikse dhe do të paguhet në vlef të 300 000 (treqind mijë) lekë, në momentin e aplikimit për lidhje nga përdoruesi.

2. Tarifa për mbikëqyrje (tarifa për kontrollin dhe vlerësimin e projektit teknik, mbikëqyrjen e ndërtimit, testimit dhe komisionimit të lidhjes). Kjo tarifë do të jetë variabël në funksion të fuqisë së plotë të kërkuar, të deklaruar nga përdoruesi dhe do të ketë vlerën 50 lekë/KVA, por në të gjitha rastet nuk do të jetë më e madhe se vlef e kufitare prej 2.5 milion (dy milion e pesëqind mijë) lekësh. Paga e kësaj tarife bëhet nga përdoruesi në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes së lidhjes dhe është parakusht për fillimin e punës.

Kostoja e aseteve të lidhjes, që përfshin koston e blerjes dhe ndërtimit të aseteve të lidhjes, mbulohet nga vetë përdoruesi, ndërsa kostoja e përforcimit të rrjetit të transmetimit dhe kostoja e O&M, mbulohen nga tarifa e shërbimit të transmetimit në përputhje me metodologjinë e tarifës së shërbimit të transmetimit, të aprovuar nga ERE.

4.7 Marrëveshja për lidhje

Nëse aplikuesi i pranohet kërkesa për lidhje, OST-ja dhe përdoruesi duhet të nënshkruajnë një marrëveshje lidhjeje.

Në marrëveshjen e lidhjes duhet të specifikohen kushtet e përgjithshme të lidhjes dhe çdo kusht specifik teknik dhe financiar i aplikuar në atë lidhje, në përputhje me Kodin e Rrjetit-Kodi i Lidhjes.

Në marrëveshjen e lidhjes duhet të përcaktohen gjithashtu:

1. përgjegjësitë për kontrollin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve;
2. përgjegjësitë për operimin e pajisjeve;
3. përgjegjësitë për sigurinë e personelit.

4.8 Refuzimi për lidhje

OST-ja do të refuzojë një lidhje vetëm nëse ka arsye teknike për një gjë të tillë, siç shkruhet në Kodin e Rrjetit-Kodi i Lidhjes. Duke pasur parasysh se përdoruesi duhet të paguajë paraprakisht, nuk duhet të ketë asnjë arsye financiare për refuzim.

4.9 Anulimi (përfundimi) i lidhjes

Kur një përdorues dëshiron të anulojë marrëveshjen e lidhjes, ai duhet të njoftojë OST-në një vit para. OST-ja ka të drejtë të kalojë në pronësi të saj pa pagesë të gjitha asetet që kanë funksionin e transmetimit (deri në kufirin e matjes tregtare).

4.10 De-energizimi

De-energizimi i lidhjes nuk llogaritet si anulim (përfundim) i marrëveshjes për lidhje.

4.11 Ankesat

Cilido përdorues i sistemit ka të drejtë të ankohet në ERE për refuzimin për lidhje dhe për çdo mosmarrëveshje me OST për ofertën për lidhje.

VENDIM
Nr.3, datë 11.1.2011

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE
MIDIS OST SHA DHE “CEZ SHPËRNDARJA” SHA

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës “V” të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.68, datë 23.6.2008, pikës 4.13 germa “a” pika 3, pikës 7 germa “g”, të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.1.2011, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s dhe marrëveshjen e transmetimit të energjisë elektrike midis OST sh.a. dhe “Cez Shpërndarja” sh.a.

konstatoi se:

- Palët e kësaj kontrate janë subjekte të legjitimuara për nënshkrimin e një marrëveshjeje për shërbimin e transmetimit të energjisë elektrike duke ditur që OST sh.a. është licencuar për aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.24, datë 26.3.2009, Cez Shpërndarja sh.a. është licencuar për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.58 datë 3.6.2008.

- Dispozitat e kësaj kontrate janë në harmoni me Modelin e Tregut të Energjisë, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.338 datë 19.3.2008, Rregullat e Tregut, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.68, datë 23.6.2008, të ndryshuar.

- Modeli i Tregut e vendos ERE-n në cilësinë e autoritetit që ka të drejtën për të miratuar këtë kategori kontrate.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Të miratojë marrëveshjen e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike midis OST sh.a. dhe “Cez shpërndarje” sh.a., dërguar në ERE me shkresën nr.6755/2 Prot. dhe nr.2538/2 Prot., datë 2.11.2010.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 31.1.2011
Doli nga shtypi më 31.1.2011

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 36 lekë